



RAPORTI VJETOR

2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR PËR FURNIZIMIN ME UJË DHE
LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA



RAPORTI VJETOR 2011

**GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS - KANALIZIME
DHE**

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR TË UJIT

Janar, 2012

Përmbajtja

Fjala e Kryetarit.....	7
1. Autoriteti Rregullator i Ujit	9
1.1 Statusi ligjor dhe përgjegjësitë	9
1.2 Aktivitetet Rregullatore	11
<i>Liçencimi</i>	<i>11</i>
<i>Vendosja e Tarifave.....</i>	<i>12</i>
<i>Vendosja e Standardeve</i>	<i>16</i>
<i>Analiza e Sektorit.....</i>	<i>18</i>
1.3 Përfshirja e konsumatorit dhe transparenca gjatë procesit rregullator	20
1.4 Konsolidimi Institucional i ERRU	22
1.5 Bashkëpunimi me Institucione dhe aktorë që veprojnë në sektorin e Ujit	23
<i>Bashkëpunimi me Institucionet në Shqipëri</i>	<i>23</i>
<i>Bashkëpunimi me Donatorët e Huaj në Shqipëri.....</i>	<i>23</i>
<i>Bashkëpunimi i ERRU me Institucione Ndërkombëtare</i>	<i>24</i>
<i>Pjesëmarrje në Aktivitete pune dhe Konferenca</i>	<i>25</i>
1.6 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU	26
<i>Të ardhurat.....</i>	<i>26</i>
<i>Shpenzimet operative.....</i>	<i>27</i>
2. Gjendja në sektorin Ujësjellës Kanalizime.....	28
<i>Performanca e shërbimit në sektorin UK</i>	<i>28</i>
<i>Cilësia e shërbimit ne sektor.....</i>	<i>29</i>
<i>Uji i pafaturuar</i>	<i>29</i>
<i>Konsumi i matur.....</i>	<i>30</i>
<i>Norma e arkëtimit</i>	<i>31</i>
<i>Mbulimi i Kostos Operative dhe Kostos Totale.....</i>	<i>31</i>
3. Këndvështrimi për vitin 2012	34
4. Rekomandime për sektorin UK.....	35

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1	Situata aktuale e licencimit	11
Grafiku 2	Ecuria në vite e licencimit	11
Grafiku 3	Tarifat për ujin e pijshëm.....	13
Grafiku 4	Tarifat për ujërat e ndotura	13
Grafiku 5	Të ardhurat	14
Grafiku 6	Ndikimi i nivelit të faturimit dhe tarifave në totalin e të ardhurave	14
Grafiku 7	Arritjet dhe <i>pritshmëritë</i> nga ndryshimi i tarifave.....	15
Grafiku 8	Të ardhurat vjetore të realizuara	26
Grafiku 9	Struktura e detajuar e planit të shpenzimeve	27
Grafiku 10	Realizimi i planit të shpenzimeve	27
Grafiku 11	Humbjet ne %.....	30
Grafiku 12	Numri i shoqërive sipas normës së arkëtimit.....	31
Grafiku 13	Mbulimi i Kostos O&M me të Ardhura / Arkëtime	31
Grafiku 14	Mbulimi i Kostos Totale me te Ardhura / Arkëtime.....	32
Grafiku 15	Struktura e shpenzimeve	32
Grafiku 16	Struktura e te ardhurave	33

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Treguesit Kryesore të Performancës (TKP)	19
Tabela 2	Trendi i treguesve të performancës.....	28
Tabela 3	Tendenca e faturimit të matur në vite	30

SHKURTIMET

TKP	-	Treguesit Kryesor të Performancës
KKRR	-	Komisioni Kombëtar Rregullator
GIZ	-	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
DPUK	-	Drejtoria e Përgjithshme Ujësjiellës Kanalizime
MPPT	-	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
METE	-	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	-	Ministria e Financave
MMPAU	-	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
ISHP	-	Instituti i Shëndetit Publik
USAID	-	Agjencia Amerikane për zhvillim Ndërkombëtar
SHUKALB	-	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë
ERSAR	-	Autoriteti Rregullator për Ujë dhe Mbeturina (Portugali)
ZRRUM	-	Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Mbeturina (Kosove)
Spektori UK	-	Spektori Ujësjiellës Kanalizime
UK	-	Ujësjiellës Kanalizime

Vizioni

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Misioni

Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë me të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Fjala e Kryetarit



Kam kënaqësinë t'iu prezantoj Raportin Vjetor 2011 që përmban një tablo të përgjithshme mbi punën ERRU për vitin 2011 si dhe një analizë të gjendjes së sektorit të shërbimeve Ujësjellës Kanalizime në Shqipëri.

Shpreh bindjen time se ky Raport Vjetor do të jetë mjaft i dobishëm në dhënien e një vështrim mbi situatën e sektorit jo vetëm shoqëritë ujësjellës kanalizime, si edhe për palët e interesit për të kuptuar sa më mirë punën dhe përpjekjet e këtyre shoqërive.

Edhe gjatë këtij viti ERRU ka vazhduar me dedikim dhe përkushtim maksimal punën për përmbushjen e misionit dhe vizionit të tij në përputhje të plotë me mandatin ligjor. Si një institucion që po i nënshtrohet në procesi të vazhdueshëm konsolidimi, ne jemi kujdesur të bashkëpunojmë, koordinohemi dhe bashkëveprojmë me të gjithë aktorët e tjerë të sektorit UK për zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve tona.

Në kuadër të funksionit të tij vendimmarrës, gjatë vitit të kaluar, Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar një sërë mbledhjesh komisioni dhe seancash pune ku rezultat i të cilave kanë qenë 47 vendime të ndryshme për miratim të tarifash dhe dhënie licencash. Gjithashtu janë aprovuar nga komisioni disa rregullore, metodologji dhe vendime administrative ku një nga më kryesorët ka qenë dhe vënia në zbatim e Metodologjisë së re të Vendosjes së Tarifave të ERRU.

Gjatë vitit 2011 ERRU është angazhuar më intensivisht për tu njohur më nga afër me punën e operatorëve UK dhe sfidat e tyre, duke i këshilluar mbi mundësitë e përmirësimit të performancës përmes takimeve dhe vizitave të shumta që ka zhvilluar. Kjo ka çuar në rritjen e besimit tek Enti Rregullator si një institucion që punon në mënyrë profesionale, që mbikëqyr dhe mbështet operatorët në punën e tyre.

Standartet e vendosura përmes aprovimit dhe zbatimit të disa instrumentave të reja rregullatore kanë bërë që të përmirësohet ndjeshëm angazhimi dhe rritja e përgjegjshmërisë së operatorëve në përmbushjen e misionit të tyre për të ofruar një shërbim sa më të mirë të mundshëm për konsumatorët e tyre. Në vitin 2011 për herë të parë ERRU arriti të hartojë dhe analizën e performancës individuale të shoqërive UK, si dhe të të gjithë sektorit për vitin 2010. Ky Raport Performance 2010 pritet të publikohet në muajt në vijim dhe do të vazhdohet puna për raportin e vitit 2011.

Gjithashtu do të doja të theksoja miratimin e Kontratës Model nga Komisioni Kombëtar Rregullator si një instrument i rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorit dhe operatorëve të licencuar në sektorin ujësjellës kanalizime. ERRU do të vazhdojë me përkushtim procesin e monitorimit të zbatimit të saj për të gjithë kategoritë e konsumatorëve.

Do doja të përgëzoja në mënyrë të veçantë shoqëritë si Sh.a UK. Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë qytet, Shkodër etj. të cilat përmes përmirësimit të ndjeshëm të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të tyre financiare kanë arritur që me të ardhurat e tyre të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes si dhe një pjesë të kostove të tjera. Gjithashtu do të doja të shprehja vlerësimin tim për të gjitha ato shoqëri që aplikuan pranë ERRU për herë të parë gjatë këtij viti ERRU për licencim dhe për ndryshim tarifash.

Enti Rregullator do të vazhdojë punën që të nxisë të gjithë operatorët në marrjen e masave për të rritur mbulimin e kostos dhe qëndrueshmërinë e tyre financiare si kusht për shërbime të një cilësie të lartë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i punës së Entit Rregullator gjatë këtij viti ka qenë dhe angazhimi për rritjen e nivelit profesional të stafit, si dhe anëtarëve të Komisionit Kombëtar Rregullator përmes një sërë aktiviteteve trajnuese brenda dhe jashtë vendit.

Do doja të shprehja në radhë të parë vlerësimi tim për angazhimin e Qeverisë dhe donatorëve, për mbështetjen e dhënë shumë prej shoqërive ujësjellës kanalizime, përmes investimeve në përmirësimin e treguesve të performancës dhe cilësisë së shërbimit në këto shoqëri.

Së fundmi dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të gjithë stafit të ERRU si dhe të gjithë atyre që kanë ofruar mbështetjen e tyre për ERRU. Në mënyrë të veçantë do të doja të falenderoja konsulentëve të GIZ për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me ERRU.

Me respekt,

Avni Dervishi



Kryetar i Entit Rregullator të Ujit

1. Autoriteti Rregullator i Ujit

1.1 Statusi ligjor dhe përgjegjësitë

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i krijuar me ligj, për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, dt. 28.03.1996, për “Kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar me ligjin nr. 9352, datë 03.03.2005, ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, si dhe ligjin nr. 9915, datë 12.05.2008.

Objektivi kryesor i këtij ligji është vendosja e një kuadri rregullator, për të garantuar dhe mbrojtur interesat publike nga njëra anë, si dhe për të krijuar një mjedis transparent ligjor dhe rregullator nga ana tjetër, me qëllim nxitjen e investimeve private në këtë sektor.

Detyrat e përgjithshme të ERRU në përputhje me ligjin janë:

- Të nxisë eficiency dhe përdorimin me efikasitet të ujit;
- Të bëjë të mundur që të liçencuarit të financojnë veprimtaritë e autorizuar nga liçenca që ka marrë;
- Të mbrojë interesat e konsumatoreve në lidhje me:
 - çmimet, tarifat dhe kushtet e shërbimit;
 - cilësinë, eficiency dhe vijueshmërinë e këtij shërbimi jetik për të gjithë konsumatorët;
- Të nxisë konkurrencën;
- Të ushtrojë veprimtarinë institucionale në mënyrë transparente dhe të gjejë një ekuilibër të drejtë ndërmjet pjesëmarrësve të këtij sektori, duke respektuar interesat e konsumatorëve, Këshillit të Ministrave, publikut dhe investitorëve.

Enti Rregullator i Ujit udhëhiqet nga Komisioni Kombëtar Rregullator, i cili ushtron këto kompetenca të përgjithshme:


- Jep liçenca për entet komerciale që janë të angazhuara në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të përdorura;
- Miraton çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit të ofruar nga operatorët që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në ato raste kur sistemet e ujësjellës-kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose pronësi të njësive të qeverisjes vendore;



Foto: Anëtarët e Komisionit Kombëtar Rregullator

- Cakton standarde për programet e investimeve dhe për shitjen e aseteve nga të licencuarit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, edhe në rastet kur këto sisteme kanë kaluar në administrim ose pronësi të njësive të qeverisjes vendore;
- Krijon dhe garanton zbatimin e standardeve të punës për të licencuarit;
- Inkurajon standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin;
- Përgatit raporte për gjendjen e sektorit për Këshillin e Ministrave dhe të grumbullon informacionin përkatës nga të licencuarit;
- Cakton tarifat e aplikueshme për licencat;
- Vendos sanksione administrative dhe monetare;
- Nxjerr rregulla për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në ligj.

Struktura dhe organika e ERRU miratohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe është si më poshtë :




1.2 Aktivitetet Rregullatore

Liçencimi


Në sektorin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura bazuar në VKM nr 660 datë 12.09.2007, VKM nr. 81 datë 12.02.2004, VKM nr. 173 datë 26.03.2004 dhe VKM nr. 809 datë 26.11.2004, gjithsej janë **56 operatore ujësjellës kanalizime** nga të cilat aktualisht: 48 operatorë janë të licencuar, 3 operatorë janë në proces dhe 5 operatorë nuk kanë aplikuar asnjëherë.

Grafiku 1 Situata aktuale e liçencimit



Ecuria në vite e liçencimit të operatorëve Ujësjellës Kanalizime ka ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit dhe një ndër objektivat kryesore për vitin 2012 mbetet liçencimi i të gjithë operatorëve UK.

Grafiku 2 Ecuria në vite e liçencimit



Gjatë vitit 2011 kanë aplikuar 12 operator ujësjellës kanalizime nga të cilat pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit në përputhje me Rregulloren e Liçencimit miratuar me Vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 kanë kaluar për vendimarrje dhe janë licencuar 6 operatorë.

Kanë aplikuar për herë të parë dhe janë licencuar 3 (tre) operatorë Ujësjellës Kanalizime si Sh.a U Korçë fshat, Sh.a U Vau i Dejës, Sh.a U Malësia e madhe. Gjithashtu ju është bërë rinovimi i licencave për efekt të ndryshimeve të drejtuesve ligjore apo teknike 2 (dy) operatorëve Ujësjellës Kanalizime. Si dhe është bërë rinovimi i licencës për efekt të mbarimit të afatit 1 (një) operatori Ujësjellës Kanalizime.

Nga aplikimet e paraqitura për pajisje me licence të subjekteve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura apo vetëm njërën prej këtyre shërbimeve janë vërejtur probleme e mëposhtme:

- Disa operatorë UK nuk kanë aplikuar asnjëherë për tu pajisur me licencë e ushtrimit të veprimtarisë konform ligjit, megjithëse vlen të theksohet se ky numër sa vjen e bëhet më i vogël.
- Operatorët UK që veprojnë në sektor kanë vështirësi në gjetjen e drejtuesve teknik. Kjo është me e theksuar në rastet e operatorëve që veprojnë në zona urbane të vogla me numër klientësh të pakët. Zgjidhja e këtij problemi mund të bëhet nëpërmjet një procesi të studiuar për Rajonalizimin/Aggregimin e këtyre operatorëve UK me operatorët më të mëdhenj që kanë me afër zonës se tyre.
- Disa njësi të qeverisjes vendore kanë krijuar sektorë pranë tyre që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura pa marrë një licencë të miratuar nga ERRU dhe në kundërshtim me ligjin nr. 8102 dt. 28.03.1996, i ndryshuar.
- Disa operatorë UK kanë akoma probleme me kalimin në pronësi të pushteteve vendore.
- Disa operatorë UK kanë probleme me regjistrimin në QKR.
- Operatorët UK që operojnë në zona të vogla urbane kanë probleme financiare pasi nuk mbulojnë dot as shpenzimet minimale për të plotësuar kushtet e licencimit.

Vendosja e Tarifave

Gjatë vitit 2011 aplikuan për ndryshimin e tarifave 14 operatorë. Komisioni Kombëtar Rregullator ka miratuar ndryshimin e tarifave për 12 prej tyre ndërsa për 2 operatorë: Sh.a UK Sarandë dhe Librazhd ka shtyrë procesin e vendimmarrjes deri në plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Më shumë se gjysma e operatorëve që kanë aplikuar gjatë këtij viti për ndryshimin e tarifave si Sh.a UK Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë, Elbasan Fshat, Bilisht operonin me tarifave të miratuara në vitin 2010. Ndryshimi i tarifave në vitin 2010 për pjesën më të madhe të këtyre operatorëve, gjatë këtij viti solli përmirësim të situatës financiare gjë e cila u krijoi mundësi për të përmirësuar shërbimin ndaj konsumatorëve duke përdorur të ardhurat e tyre për kryerjen e investimeve të domosdoshme e të nevojshme, si dhe rritjen e shkallës së mbulimit të kostove.


Analiza tekniko-ekonomike e aplikimeve të paraqitura tregoi se këta operatorë kanë mundur të plotësojnë pjesën më të madhe të rekomandimeve të bëra nga KKRR në aplikimin e mëparshëm për ndryshim tarife.

Gjithashtu, kanë paraqitur për herë të parë aplikimet për ndryshimin e tarifave pranë ERRU, Sha U Orikum dhe Sha U Shkodër (Fshat) duke rritur kështu nivelin e rregullimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura brenda kuadrit ligjor. Numri i operatorëve që kanë tarifa të miratuara nga ERRU ka ardhur duke u rritur. Aktualisht nga 56 operatorë 44 operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU.


Kjo situatë është rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm me operatorët për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me rregullimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura brenda kuadrit ligjor.

Shqyrtimi i aplikimeve për ndryshimin e tarifave është bazuar në analizën e treguesve tekniko-ekonomik mbi situatën aktuale dhe atë të parashikuar duke evidentuar problemet kryesore për secilin prej tyre, shkaqet dhe mundësitë e përmirësimit. Analiza ka konsistuar në vlerësimin e të dhënave të paraqitura, në krahasimin e tyre dhe treguesve të punës mbi bazën e të cilëve operatori ka parashikuar ndryshimin e tarifave, krahasimin me ato të periudhës paraardhëse, tendencën e tyre për tre vitet e fundit si dhe në analizën e të gjithë faktorëve që ndikojnë në ndryshimin e tyre. Ndryshimi i tarifave ka patur gjithmonë trend rritës.

Grafiku 3 Tarifat për ujin e pijshëm



Grafiku 4 Tarifat për ujërat e ndotura



Rritja mesatare e tarifave për shërbimin e ujit për konsum publik është rreth 16%, ndërsa rritja e tarifave për shërbimin e largimit dhe / ose trajtimit të ujërave të ndotura është rreth 27%. Tarifatat e miratuara në vitin 2011 kanë synuar mbulimin e kostove në rritje.


Pjesa më e madhe e investimeve që janë kryer dhe po kryen në sektor për zgjerimin edhe rehabilitimin e sistemeve UK janë financuar nga donatorë të huaj nëpërmjet granteve dhe kredive. Shlyerja e këtyre kredive si dhe mbulimi i kostove në rritje të operimit dhe mirëmbajtjes për shërbimin e furnizimit me ujë dhe veçanërisht për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura kërkon sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme.

Në dallim nga periudhat e mëparshme, në vitin 2011 operatorë si Sh.a UK Tiranë dhe Durrës kanë synuar përmirësimin dhe zgjerimin e zonës së tyre të shërbimeve, nëpërmjet investimeve

duke përdorur mjetet e tyre financiare, proces të cilin parashikojnë ta zgjerojnë në periudhën në vazhdim, fakt i cili është reflektuar edhe në kërkesën për ndryshimin e tarifave.

Objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve në të njëjtën kohë me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit, ashtu siç parashikohet në Vizionin dhe Misionin e tij.


Grafiku 5 Të ardhurat



Si rezultat i rritjes së tarifave, të ardhurat në sektor UK do të rriten. Pra, jo vetëm investimet kapitale që janë kryer dhe po kryen por edhe tarifat e reja të miratuara do të bëjnë të mundur rritjen e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Vetëm nga ndryshimi i tarifave për 12 shoqëri, të ardhurat në sektorin ujësjellës kanalizime do të rriten rreth 25%.

Mbështetur në strategjinë e qeverisë për zhvillimin e sektorit UK në Shqipëri, nëpërmjet rritjes së tarifave është synuar së pari mbulimi i kostos operative duke bërë të mundur që gradualisht të arrihet dhe mbulimi i kostos totale. Rritja e të ardhurave vjen si rezultat i ndryshimit të tarifave dhe nivelit të faturimit.

Grafiku 6 Ndikimi i nivelit të faturimit dhe tarifave në totalin e të ardhurave



Duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të secilit operator dhe kushtet specifike të operimit nëpërmjet miratimit të ndryshimit të tarifave gjithmonë është synuar rritja dhe përmirësimi i mëtejshëm i performancës ekonomiko financiare dhe cilësisë së shërbimeve UK.

Grafiku 7 Arritjet dhe *pritsshmëritë* nga ndryshimi i tarifave

Sh.a UK Tiranë Durrës Shkodër Korçë Gjirokastrë	• Mbulimi i kostos O&M • Mbulimi i pagesës së kredive dhe interesave të tyre • Tendencë drejtë mbulimit të kostos Totale
Sh.a UK Mirditë Bilisht Elbasan (F) Lezhë	• Përmirësimi i mbulimit të kostos O&M • Uljen e nevojës për subvencion • Tendencë drejtë mbulimit të kostos O&M
Sh.a U Shkodër (F) Orikum	• Tarifa të miratuara për herë të parë nga ERRU • Dyfishimi i të ardhurave, por shkalla e mbulimit të kostos O&M është e ulët (rreth 50%) • Domosdoshmëri për subvencionim nga buxheti i shtetit • Tendenca rritje graduale e të ardhurave nga aktiviteti • Ulja e nevojës për subvencion

Komisioni Kombëtar Rregullator ka qenë transparent për të gjitha vendimet e tij si për njësitë e qeverisjes vendore, operatorët, donatorët edhe për konsumatorët. KKRR ka bërë transparent mendimin e tij përpara çdo vendimmarrje si me shkrim ashtu edhe në takime me të gjithë të interesuarit.

Në vitin 2011, operatorët që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura paraqiten aplikimet për ndryshimin e tarifave mbështetur në “Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (Miratuar me Vendimin e Komisionit Kombëtar të ERRU nr. 32 datë 21.12.2009).

ERRU me mbështetjen e GIZ, tashmë ka përfunduar hartimin e metodologjisë së re të vendosjes së tarifave e cila ka sjellë një sërë risish jo vetëm për procesin e miratimit të tarifave por edhe në elementet që do të përdoren për realizimin e tij.

Rregullimi i tarifave sipas kësaj metodologjie përfshin kontrollin e kostove dhe cilësinë e shërbimit duke dhënë stimuj që operatorët të përmirësohen. Miratimi për rritjen e tarifave do të jetë i kushtëzuar vetëm për operatorët që arrijnë të përmirësojnë performancën teknike dhe financiare.

Për realizimin e këtij procesi, ERRU do të përdorë elemente të rinj duke filluar nga struktura tarifore, modeli i aplikimit, përdorimi i benchmarking, seanca dëgjimore, mbështetje për hartimin e planit të biznesit, etj.

Miratimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bëjë të mundur rritjen e transparencës në vendimmarrje, rritje të shkallës së mbulimit të kostove, përmirësim të performancës tekniko - ekonomike, me shumë pavarësi dhe përgjegjësi në menaxhimin e aktivitetit dhe për periudhën

afat-mesme, miratim të tarifave edhe për më shumë se një vit për operatorët që do të kenë hartuar planet e biznesit.

Gjatë vitit 2011, ERRU ka pranuar kërkesën për aplikimin për ndryshimin e tarifave sipas metodologjisë së re të dy operatorëve Sh.a UK Pogradec dhe Sh.a UK Fier për të qënë pilot në zbatimin e kësaj metodologjie me mbështetjen e GIZ.

Për herë të parë gjatë këtij viti është hartuar raporti i vlerësimit të operatorëve për vitin 2010 mbi bazën e treguesve të performancës të përcaktuar nga ERRU. Në muajin maj të këtij viti do të përfundojë raportin e vlerësimit të performancës së operatorëve për vitin 2011.

Vendosja e Standardeve

Një nga kompetencat kryesore të Komisionit Kombëtar Rregullator është krijimi dhe garantimi i standardeve të punës për të liçencuarit si dhe inkurajimi i standardeve dhe rregullave uniforme për të gjithë sektorin.

Gjatë vitit 2011 Komisioni Kombëtar Rregullator ka ndërmarrë disa iniciativa si më poshtë:

- 1) Miratimi i Kontratës Model për shërbimet ujësjellës kanalizime, ndërmjet konsumatorit dhe operatorëve të licencuar në këtë sektor.**

Kjo kontratë rregullon marrëdhëniet juridike midis palëve për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Çështjet kryesore të kësaj kontrate janë:

- Përkufizimet dhe shpjegimet në lidhje me shërbimin në sektorin UK;
- Të drejtat dhe detyrat e konsumatorëve dhe operatorëve të shërbimit;
- Tarifat, pagesat dhe ujëmatësit;
- Cilësia e ujit dhe mbrojtja e mjedisit;
- Kundërvajtjet, ndryshimet, pezullimi dhe zgjidhja e kontratës.

Hartimi i kësaj kontrate filloi në tetor të vitit 2010, si iniciativë e ERRU në bashkëpunim me METE dhe me mbështetjen e UNDP. Në fillim të vitit 2011 draft kontrata u diskutua dhe u konsultua me aktorët kryesore të sektorit, dhe në shkurt 2011 ky draft u miratua me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator.

Modeli i kontratës ka filluar të zbatohet nga pjesa më e madhe e operatorëve për rregullimin e marrëdhënies me konsumatorët e rinj dhe për kategorinë e konsumatorëve publikë e privatë. Gradualisht ky model do të zbatohet edhe për kategorinë e konsumatorëve familjarë dhe mendohet të përfundojë në vitin 2013.

2) Metodologjia për vendosjen e tarifave

Nisur nga zhvillimet aktuale në sektorin ujësjellës kanalizime në vend, ERRU ndërmori nismën për rishikimin e Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave për operatorët e shërbimit ujësjellës kanalizime. ERRU, pas një pune të gjatë, bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe me mbështetjen e GIZ, hartoi metodologjinë e re të vendosjes së tarifave.

Për hartimin e metodologjisë së re u morën në konsideratë legjislacioni në fuqi për sektorin ujësjellës kanalizime, metodologjia ekzistuese për vendosjen e tarifave, të gjithë dokumentat dhe dispozitat kryesore lidhur me këtë çështje, dhe mendimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në sektor.

Metodologjia e re paraqet një proces për vendosjen e tarifave ku përfshihen stimujt për operatorët e shërbimit ujësjellës kanalizime për të përmirësuar performancën e tyre për shërbime më të mira për klientët dhe për të arritur qëndrueshmërinë e tyre financiare.



Kjo metodologji është dokumenti bazë në procesin e miratimit të tarifave. Ndër risitë që kjo metodologji sjell përmendim:

- Struktura e tarifës do të përgatitet nga vetë operatorët me qëllim që ata të realizojnë objektivat e politikës tarifore të cilat janë:
 - mbulimi i kostove;
 - efikasiteti menaxhues;
 - përballueshmëria (marrja në konsideratë e nevojat bazë të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulta);
 - efikasiteti mjedisor (tarifa më të larta për nivele të larta konsumi me qëllim inkurajimin e ruajtjes së burimeve);
- Ndarja e tarifës në dy komponent - komponenti fiks që do të mbulojë kostot fikse dhe komponenti volumetrik që do të lidhet me sasinë e ujit të konsumuar;
- Tarifa bllok në rritje - ku blloku i parë do të ketë tarifë më të ulët dhe në blloqet e tjera tarifa do të vijë në rritje, pra për nivele të larta konsumi do të ketë tarifë më të lartë;
- Monitorimi nga ERRU i tarifave të shërbimeve të tjera (tarifë për lidhje, rilidhje, instalim matësi etj);
- Tarifa për më shumë se një vit;
- Procedurë e përshpejtuar për operatorët me skema të vogla shërbimi dhe ata që plotësojnë apo tejkalojnë objektivat e performancës;
- Organizimi i seancave dëgjimore dhe përfshirja e tyre si pjesë në procesin e miratimit të tarifave;
- Miratimi i tarifave pas marrjes së informacionit të detajuar mbi subvencionet e përfituara nga operatori;
- Analiza e kostos – duke bërë korrigjimin e kostove të tepërta dhe marrjen në konsideratë vetëm kostot e nevojshme;
- Analiza e performancës – në bazë të 10 treguesve do të bëhet listimi i operatorëve duke bërë kështu “vlerësimin” e operatorëve më të mirë dhe “penalizmin” e operatorëve me performancë të dobët;

- Llogaritja e “tarifës mesatare” duke marrë parasysh normën e arkëtimit e cila është një tregues domethënës i punës së operatorit;

3) Manuali për Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës në lidhje me shërbimet e sektorit ujësjellës - kanalizime.

Manuali përkatës për anëtarët e këshillave mbikëqyrës është përgatitur nga ERRU dhe synon jo vetëm përmirësimin e performancës së tyre por përcakton edhe bazën ligjore të veprimtarisë së tyre, rolin në monitorimin e performancës së shërbimit UK si dhe të emërimit apo caktimit të drejtuesve ligjorë të shoqërive, etj.

4) Zbatimi i rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të operatorëve (Kodi i Ujit).

Kodi i Ujit është aprovuar me vendim Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009, dhe ka si objektiva kryesorë:

- përcaktimin e rregullave dhe kërkesave që duhet të përmbushin operatorët e shërbimit për një shërbim sasior dhe cilësor në sektor;
- krijimin e një marrëdhënie të re ligjore ndërmjet pronarëve të aseteve (njësive të qeverisjes vendore) dhe administratorëve të këtyre aseteve.

ERRU dhe DPUK janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kësaj rregullore.

Gjatë vitit 2011, ERRU ka miratuar dhënien e licencave dhe ka aprovuar tarifa të reja vetëm për ata operatorë që e kanë miratuar Kodin e Ujit. Deri më sot, 30 operatorë, e kanë firmosur dhe po e zbatojnë këtë rregullore.

5) Studimi kombëtar rreth Shërbimeve për klientin në shoqëritë ujësjellës kanalizime.

Ky studim ka një rëndësi jo vetëm për njohjen e situatës aktuale të shërbimit për klientin por edhe për vendosjen e objektivave të duhura me qëllim përmirësimin e cilësisë e këtij shërbimi.

Në shoqëritë UK rritja e kapaciteteve profesionale të stafit dhe trajnimi i tyre janë aspekte të rëndësishme që duhet të mbahen parasysh nga shoqëritë sepse një shërbim cilësor ndaj klientit është primar në funksionimin e tyre.

Analiza e Sektorit

Në përmbushje të detyrimit të tij ligjor, siç përcaktohet në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar, neni 14, pika “f”, si dhe neni 31, pika (1) a), “KKRR përgatit raporte për gjendjen e sektorit, nëpërmjet mbledhjes së informacionit nga operatorët”, si dhe në kuadër të konsolidimit të tij institucional, ERRU vijon përpjekjet e tij, duke prezantuar para institucioneve me të larta të vendit sikundër janë Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave raporte, të cilat pasqyrojnë analizën e punës njëvjeçare të Entit Rregullator dhe gjendjes së sektorit UK në tërësi.

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim nr. 38, datë 23.07.2010 “ *Për miratimin e treguesve kryesore të performancës (TKP) dhe peshës së tyre*”, vendosi Treguesit Kryesorë të Performancës së operatoreve të shërbimit UK dhe peshat respektive të tyre si më poshtë:

Tabela 1 Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP)

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	Pesha
1	Mbulimi Kostos Totale	10
2	Mbulimi Kostos Operim & Mirëmbajtjes	10
3	Sasia e Ujit të Matur	15
4	Niveli i Arkëtimit	18
5	Ecuria e Furnizimit me Ujë (në ore)	10
6	Cilësia e ujit të Pijshëm	15
7	Efienca e Stafit (Staf/1000 lidhje)	5
8	Mbrojtja e Mjedisit	5
8	Humbjet e Ujit	8
10	Perceptimi Rregullator	2
11	Zona e mbulimit me Kanalizime	2

Mbi bazën e TKP mundësohet një vlerësim i ecurisë së proceseve rregullatore ndër të cilat do të përmendim aspektet e licencimit dhe të vendosjes së tarifave. Gjendja dhe ecuria e këtyre treguesve do të përbënin bazën mbi të cilat do të vlerësohej shërbimi që ofron i licencuari, si edhe përcaktimi i duhur i kërkesës për ndryshim tarife nga ana e tij

ERRU nëpërmjet Benchmarking, mbi bazë të targetave respektive për çdo TKP, analizon performancën e operatoreve kundrejt tyre, duke nxjerr në pah edhe praktikën “më të mira”, të cilat do të shërbejnë si referenca në të ardhmen për çdo operator që të përmirësojë treguesit e tij drejt rezultateve më të mira.

TKP dhe analiza e tyre përbëjnë aksin e trajtimit të performancës individuale të shoqërive UK dhe sektorit në tërësi. Performanca individuale e operatoreve bazuar mbi këta tregues paraqet një vlerësim sa më real të ecurisë tekniko-ekonomike, për të kuptuar punën dhe përpjekjet e tyre për përmirësimin në cilësisë së shërbimit.

Aplikimi dhe finalizimi i proceseve si më sipër kërkon së pari të dhëna të sakta dhe cilësore, të cilat përbejnë bazën mbi të cilin do të bëhet vlerësimi dhe analiza e performancës. Në kuadër të bashkëpunimit institucional ERRU dhe DPUK kanë përgatitur kornizën e të dhënave të duhura që kërkohet në analizat e këtyre proceseve.

ERRU në ushtrim të mandatit të tij rregullator zhvillon aktivitetin e tij të plotë institucional dhe në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë që kontribuojnë në sektor.

Si një nga aktorët kryesorë në sektorin UK, Enti Rregullator ushtron funksionin e tij duke patur në themel përgjegjësitë ligjore, Misionin dhe Vizionin e tij, për rregullimin e sektorit UK, mbrojtjes së interesave të konsumatoreve në të gjithë vendin, si dhe nga ana tjetër për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e BE dhe me objektivin e zhvillimit të mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë mjedisore.

KKRR aprovoi në shtator 2011 metodologjinë e re të vendosjes së tarifave, e cila është e detyrueshme për tu zbatuar nga të gjitha shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri. Në

metodologjinë e re TKP luajnë një rol të rëndësishëm gjatë këtij procesi të miratimit të tarifave duke nxitur performancën e shoqërive UK në mënyrë që të arrijnë qëndrueshmëri financiare, duke ofruar shërbime më të mira për klientët e tyre.

Hartimi dhe zbatimi i një plan biznesi do të kërkonte një menaxhim me të mirë të shoqërive dhe në veçanti përcaktimin e objektivave të qartë të tyre. Gjatë procesit të miratimit të tarifave do të merret në konsideratë ecuria e TKP si bazë për vlerësimin e saktë të planit tarifar të përgatitur nga vetë ata.

Mbrojtja e konsumatorit përbën një nga çështjet kryesore të punës së ERRU. Analiza, vlerësimi dhe ndjekja e saj nuk mund të kenë atë efikasitet pa marrë në vlerësim dhe treguesit respektive të cilët tregojnë cilësinë e shërbimit të ofruar nga i licencuari. Vetëm mbi këtë bazë do të bëhet e mundur ruajtja e ekuilibrit midis qëndrueshmërisë financiare të operatorit dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Përmirësimi i punës nga ana e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës, nëpërmjet trajnimeve të ndërmarra nga ERRU do të shërbejë për një ndryshim cilësor të pozicionit të Këshillit Mbikëqyrës, gjë që çon dhe në një performancë më të mirë të vetë shoqërisë. Vlerësimi i ecurisë së punës të drejtuesve të shoqërive UK nëpërmjet TKP dhe një vlerësimi nga Pushteti Vendor dhe Këshilli Mbikëqyrës, bën të mundur vendosjen e targeteve të qarta për përmirësimin e efijencën së shërbimit të shoqërisë.

Përfundimi i studimeve si “Shërbimi ndaj Klientit”, apo “Perceptimi Konsumator”, të planifikuar për vitin në vijim do të përcaktojë qartë objektivat e duhura të cilat do të sigurojnë një shërbim më të mirë të operatorëve ndaj konsumatorëve.

Ecuria e treguesve siç janë: cilësia e ujit, furnizimi, mbrojtja e mjedisit luajnë një rol të rëndësishëm mbi çështjet e mbrojtjes konsumatore dhe mjedisit në periudhe afatgjatë.

1.3 Përfshirja e konsumatorit dhe transparenca gjatë procesit rregullator

Viti 2011 mund të quhet viti i vendosjes së standarteve të përfshirjes së konsumatorit në procesin transparent të vendosjes së tarifave si dhe në atë të monitorimit të veprimtarisë së operatorëve.

Metodologjia e re e vendosjes së tarifave për herë të parë sjell si risi përfshirjen e konsumatorit që në fillim të procesit të aplikimit për tarifë veçanërisht për operatorët e mëdhenj përmes kërkesës për organizimin e seancave dëgjimore me publikun nga ana e operatorëve.

Po kështu në modelin e ri të kontratës së shërbimit, përveç sanksionimit të të drejtave të konsumatorit në marrëdhëniet operator-konsumator, janë shtuar edhe mundësitë e tij për tu ankuar tek të gjithë institucionet e ngritura për mbrojtjen e tij duke krijuar ciklin e plotë të ankimit që nga operatori, ERRU, Avokati i Popullit, Komisioni për mbrojtjen e konsumatorit dhe duke përfunduar procesin në gjykatë. Vetëm gjatë vitit 2011 në ERRU janë paraqitur dhe trajtuar 31 ankesa nga konsumatori.

Konsumatori, kur konstaton se i shkelen të drejtat e parashikuara sipas kësaj kontrate, ka të drejtën e paraqitjes së ankesës pranë njësisë përkatëse për marrëdhënien me publikun tek ERRU si i vetmi institucion rregullator në sektorin UK.

Më pas, konsumatori mund të paraqesë ankesë edhe tek Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatoreve, Avokati i Popullit ose tek institucione të tjera që janë të ngarkuara nga ligji për mbrojtjen e konsumatorëve. Institucionet apo organet administrative që kanë marrë një ankesë nga konsumatori duhet të bashkëpunojnë me ERRU për informimin dhe mundësinë e zgjidhjes së këtyre ankesave.

Përveç vendosjes së këtyre standarteve në përfshirjen e konsumatorit, një ndër detyrat kryesore të punës së ERRU është edhe mbrojtja e konsumatorëve në lidhje me cilësinë e shërbimit nga operatorët apo vendosjen e tarifave. Gjatë vitit 2011, ERRU ka ndërmarrë një **Studim kombëtar rreth shërbimeve për klientin nga operatorët UK.**

Ky është studimi i parë i kryer për shërbimet ndaj klientit në operatorët e UK me mbështetjen e programit të përbashkët të kombeve të bashkuara për qeverisjen ekonomike, reformën rregullatore dhe zhvillimin pro të varfërve.

Ky studim vjen në një moment kur po rriten përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit është një kusht i domosdoshëm që klientët të pranojnë tarifa më të larta, ndërkohë që është e vërtetë se në raste si ato të Shqipërisë përmirësimi i cilësisë së shërbimit kërkon një investim në infrastrukturë dhe kohë.

Disa përmirësime të cilësisë së shërbimit mund të arrihen relativisht shpejt dhe me një kosto modeste duke i kushtuar më shumë vëmendje marrëdhënieve ndërmjet operatorëve dhe klientëve të tyre. Marrëdhëniet më të mira me klientët nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve për klientët mund të ndihmojnë që klientët të pranojnë të paguajnë tarifa më të larta, gjë që do të sillte një performancë më të mirë financiare të shoqërive dhe si përfundim do të sillte përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të shërbimit. Një punë të mirë në krijimin e marrëdhënieve klient - operator kanë bërë Sh.a UK Tiranë, Durrës, Pogradec, Shkodër e Korçë.

Studimi krahason shërbimet ndaj klientit të 56 operatorëve shqiptarë të UK me praktikën e mira ndërkombëtare të 7 operatorëve europianë dhe amerikanë duke identifikuar mangësitë në performancë.

Objektivat kryesorë të këtij studimi kanë qënë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve shqiptarë të ujësjellës-kanalizime për rëndësinë e orientimit të klientëve nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve për klientin, si një mënyrë relativisht jo e kushtueshme dhe e shpejtë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe lehtësimin e pranimit nga klientët të rregullimeve aq të nevojshme të tarifave;
- T'u tregojë operatorëve UK rrugën për të ardhmen duke u ofruar rekomandime për veprimet që duhen ndërmarrë për të trajtuar mangësitë e identifikuara të performancës në menaxhimin e shërbimit për klientin.

Studimi ka konkluduar se ka ardhur koha të përgatiten Standardet e Shërbimit për Klientin, si dhe një Udhëzues të Shërbimeve për Klientin për t'u zbatuar në të gjithë operatorët e shërbimit të UK në Shqipëri.

Gjithashtu, për të njohur sa më mirë perceptimin e klientëve ndaj këtij shërbimi, ERRU me mbështetjen e një programi të UNDP ka filluar një **Studim për perceptimin e qytetarëve për cilësinë e shërbimit të ujit** në 10 rrethe të vendit.

Sondazhi i perceptimeve të qytetarëve për shërbimet e ujit ka si qëllim të sigurojë të dhëna në perceptimet e qytetarëve për cilësinë e shërbimeve të ujit. Këto të dhëna mund të përbëjnë një mjet për krijimin e politikave rregullatore dhe për të monitoruar ndikimet e reformave në cilësinë e këtyre këtij shërbimi.

Në procesin e vendosjes së tarifave, mbrojtja e konsumatorit është bërë jo vetëm nëpërmjet ndryshimit të studiuar të tarifave bazuar në përmirësimin e treguesve të performancës por edhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në këtë proces, rritjes së kontakteve direkt me konsumatorët për cilësinë e shërbimit, rritjes së transparencës gjatë procesit të vendosjes së tarifave, etj.

Të gjitha vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator dhe aktiviteti i tij, është pasqyruar në mënyrë të vazhdueshme në faqen e internetit të institucionit www.erru.al si dhe në mediat lokale dhe kombëtare.

Në procesin e vendosjes së tarifave, ERRU përpara se të marrë vendimet përkatëse, ka kërkuar edhe mendimin e pushtetit vendor. Njësitë e qeverisjes vendore janë institucionet përgjegjëse për ushtrimin e funksioneve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha e të ujërave të ndotura. Këto institucione përgjigjen përballë qytetarëve për këto shërbime, pasi ato janë edhe më afër tyre.

Për këto arsye, marrja e mendimit të njësive të qeverisjes vendore në procesin e miratimit të tarifave, ka qënë jo vetëm një kërkesë ligjore e domosdoshme por edhe një standard minimal i procesit vendimmarrës të KKRR, i cili garanton përfshirjen në këtë proces edhe të njësive vendore.

1.4 Konsolidimi Institucional i ERRU

Gjatë vitit 2011, ERRU ka vazhduar konsolidimin institucional të tij jo vetëm përmes trajnimeve dhe kualifikimit të punonjësve të tij, forcimit të bashkëpunimit me institucionet kombëtare e ndërkombëtare por edhe përmes angazhimeve mjaft serioze në konferenca, seminare dhe workshope të organizuara nga vetë ERRU si dhe aktorë të tjerë që veprojnë në sektorin e ujit.

Mjafton të përmendim organizimin e workshopeve për prezantimin e modelit të kontratës, metodologjisë së re të tarifave tek operatorët, konferencën në lidhje me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit apo pjesëmarrjeve aktive në konferencat e ujit të organizuara në Tiranë, Amsterdam dhe Stokholm.

Viti 2011 ka qënë një vit i ngarkuar me punë për trajtimin e disa çështjeve themelore të aktivitetit të institucionit siç janë:

- Përcaktimi dhe aprovimi i treguesve për vlerësimin e performancës së operatorëve.
- Hartimi dhe aprovimi i metodologjisë së re të vendosjes së tarifave.
- Përpunimi i strukturës për raportin vjetor dhe raportin e performancës të ERRU- së.
- Përgatitja dhe aprovimi i manualit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, trajnimi dhe çertifikimi i anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës të 10 operatorëve UK.
- Rritja e transparencës, në aktivitetet vendimmarrëse të ERRU si dhe në komunikimin ndërmjet operatorëve dhe konsumatorëve.

Grupe të ndryshme pune janë ngritur dhe kanë trajtuar këto çështje duke dhënë kontributin e tyre në bashkëpunim me konsulencën e GIZ.

Gjate këtij viti ERRU ka punuar edhe për përmisimin e strukturës së saj organizative. Në muajin prill projekt-struktura e miratuar nga KKRR është paraqitur për miratim pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe pritet miratimi i saj. Aktualisht ERRU ushtron aktivitetin e tij në dy ambiente pune të pamjaftueshme, që ndodhen në distance nga njëri tjetri dhe që nuk garantojnë ambientet e duhura të punës konform standarteve për të gjithë punonjësit.

1.5 Bashkëpunimi me Institucione dhe aktorë që veprojnë në sektorin e Ujit

Bashkëpunimi me Institucionet në Shqipëri

ERRU duke iu përmbajtur kërkesave të ligjit 8102, strategjisë së qeverisë për të mundësuar efektivitetin e shërbimeve UK, synimit për përmirësimin e performancës së sektorit dhe mbrojtjes së konsumatorit, si dhe synimeve të saj për bashkëpunim me të gjitha palët e interesit, ka patur një bashkëpunim mjaft të frytshëm me institucionet e mëposhtme:

- Kuvendi i Shqipërisë
- Këshilli i Ministrave
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE)
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU)
- Autoriteti i Konkurrencës
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
- Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve të Shqipërisë (SHUKALB)
- Universiteti Europian i Tiranës (UET)
- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Bashkëpunimi me Donatorët e Huaj në Shqipëri

ERRU ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me donatorët e huaj si më poshtë:

- **Bashkëpunimi me Qeverinë Gjermane** përmes projektit të financuar nga **GIZ** i cili ka filluar që prej vitit 2009. Në kuadër të kësaj marrëveshje, GIZ ka dhënë ndihmesën e saj për:
 - a) Forcimit institucional të ERRU;
 - b) Metodologjisë së re të vendosjes së Tarifave;
 - c) Përcaktimin e Treguesve të Performancës;
 - d) Raportit Vjetor dhe Raportit të Performancës,

Si dhe janë organizuar një sërë workshopesh, konferenca dhe është bashkëpunuar në shumë drejtime të tjera nga ku si rrjedhojë po shqyrtohet edhe ideja për zgjerimin e projektit.

- **Bashkëpunimi me programin e UNDP** për qeverisjen vendore ka qënë shumë frytdhënës për:
 - Hartimin dhe aprovimin e kontratës model ndërmjet operatorëve dhe konsumatorëve si dhe trajnimin e operatorëve në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate;
 - Studimin e shërbimit ndaj klientit të operatorëve UK;
 - Studimin për perceptimin e konsumatorëve të shërbimit në sektorin UK.
- **Bashkëpunimi me USAID** përmes programit të tij për qeverisjen vendore në Shqipëri i cili është krijuar për të ofruar trajnim dhe asistencë teknike, për aftësimin e disa njësive të qeverisjes vendore të përzgjedhura për rritjen e zhvillimit ekonomik lokal.

Në kuadër të kësaj nisme është punuar në bashkëpunim të ngushtë midis ERRU, GIZ, dhe USAID për hartimin dhe aprovimin e manualit të trajnimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës si dhe organizimin e disa workshopeve në lidhje me detyrat dhe të drejtat e tyre gjatë aktivitetit si organ mbikëqyrës i Sh.a.-ve në sektorin UK.

Bashkëpunimi i ERRU me Institucione Ndërkombëtare

- **ERRU – ERSAR / Portugali**

Ky bashkëpunim 2 vjeçar ka vazhduar të jetë mjaft i frytshëm edhe gjatë këtij viti. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me ERSAR, një ekip i ERRU ka bërë një vizitë studimore pranë këtij institucioni në lidhje me marrëdhëniet me konsumatorin, procesin e vendosjes së tarifave, etj. Gjithashtu me ftesë të ERRU, Presidenti i ERSAR, z. Jaime Baptista prezantoi eksperiencën portugeze në lidhje me shërbimin ndaj klientit në Konferencën e organizuar nga ERRU për kujdesin ndaj klientit. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe u organizua një takim i përbashkët ndërmjet presidentit të ERSAR, kryetarit të ERRU, konsulencës së GIZ dhe zëvendësministrit të MPPT ku u diskutua për çështjet rregullatore në vendet përkatëse si dhe për zgjerimin e kontakteve dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të të dy vendeve që operojnë në fushën e ujit. Gjithashtu Presidenti i ERSAR, pati një takim mjaft të frytshëm dhe me këshilltaren e Kryeministrit për çështjet e ujit.



Foto: Presidenti i ERSAR z. Jaime Baptista në zyrat e ERRU

- **ERRU – ZRRUM / Kosovë**

Edhe për vitin 2011 ERRU dhe ZRRUM zhvilluan workshop-in e përvitshëm në qytetin e Ohrit bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve me qëllim kryesor shkëmbimin e eksperiencave rregullatore. Temat rreth të cilave u fokusua ky workshop ishin mbi legjislacionin, liçencimin, tarifat dhe analizën e treguesve të performancës.

- **ERRU – Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA)**

ERRU është anëtare me të drejta të plota i këtij institucioni dhe ka marrë pjesë në shume aktivitete të organizuara nga ky institucion siç kanë qënë java ndërkombëtare e ujit në Amsterdam, Stokholm apo konferencat ndërkombëtare në lidhje me çështjet e ujit të organizuara prej këtij institucioni në Stamboll dhe Stokholm.

- **ERRU – Instituti Ndërkombëtar i Ujit në Stokholm (SIWI)**

Vizita e punës e anëtarëve të KKRR e organizuar pranë SIWI në maj 2011, dha mundësinë e prezantimit të ERRU pranë këtij institucioni të mirënjohur në hartimin e politikave botërore në fushën e ujit. Në këtë vizitë u bë e mundur edhe prezantimi i Kontratës Model të shërbimit ndërmjet operatorit dhe klientit e hartuar nga ERRU. Gjithashtu, çështje si Metodologjia e vendosjes së tarifave, Standartet e shërbimit në sektorin UK, Liçencimi i operatorëve UK etj, ishin në fokus të takimit të zhvilluar me drejtuesit më të lartë të këtij institucioni.

Pjesëmarrje në Aktivitete pune dhe Konferenca

- **Aktivitete të organizuara nga ERRU**

- Workshope me të gjithë operatorët që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin UK për të prezantuar Kontratën Model të shërbimit;
- Workshope me të gjithë operatorët për prezantimin e metodologjisë së re të vendosjes së tarifave;
- Workshope për trajnimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës.

- **Pjesëmarrja e ERRU-së në aktivitetet e Sektorit UK**

- Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga MPPT për strategjinë e qeverisë në sektorin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, ERRU jo vetëm ka marr pjesë në grupe pune për formulimin e strategjisë por ka qënë pjesë aktive në panele diskutimesh me sugjerimet e saj deri në përfundimin e kësaj Strategjie Kombëtare.
- Kontributi i ERRU-së si një aktor i rëndësishëm rregullator në sektorin UK ka qënë gjithashtu i vlefshëm në aktivitetet e tjera të zhvilluara nga MPPT në lidhje me Masterplanin i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për Shqipërinë.
- Në konferencën e ujit që u zhvillua nga SHUKALB në muajin nëntor të këtij viti ERRU kishte një sesion të veçantë në lidhje me Kujdesin ndaj Klientit dhe rolin e saj në përmirësimin e cilësisë së shërbimit.



Foto: Në konferencë, në Javën Kombëtare të Ujit

• Marrëdhëniet e ERRU me Median

Marrëdhëniet me mediat vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në shumë drejtime dhe në këtë kontekst ERRU gjatë vitit 2011 është angazhuar përmes formave të ndryshme të ndikojë në informimin e institucioneve dhe publikut të gjerë në mënyrë transparente për të gjitha vendimmarrjet e institucionit në lidhje me tarifën, kontratën model, metodologjinë së re vendosjes së tarifave, kujdesit ndaj klientit, etj. Kryetari i ERRU dhe anëtarët e Komisionit Kombëtar Rregullator kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në emisione të ndryshme televizive për të informuar publikun në lidhje me vendosjen e standarteve, tarifave të shërbimit në sektorin UK, etj. Të gjitha këto aktivitete janë të pasqyruara në faqen zyrtare të ERRU-së www.erru.al.

1.6 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU

Të ardhurat

Si institucion i pavarur, që nuk financohet nga buxheti i shtetit, ERRU mbulon të gjitha shpenzimet për ushtrimin e veprimtarisë, nëpërmjet pagesave rregullatore e pagesave për liçencime që kryejnë operatorët e liçencuar që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Në vitin 2011, ERRU ka marrë financime edhe nga donatorë të huaj, e konkretisht nga projekti gjerman GIZ.

Sikurse në vitet e mëparshme edhe për vitin 2011, ERRU ka arritur të sigurojë të ardhura që garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve vjetore të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të vet në përmbushje objektivave vjetore në funksion të misionit e vizionit të tij.

Për vitin 2011, të ardhurat totale të realizuara nga burimet e financimit, janë 31,803 mijë lekë, prej të cilave 31,077 mijë lekë janë nga pagesat rregullatore, 170 mijë lekë nga pagesat për liçencimet dhe 556 mijë lekë si të ardhura të tjera.

Grafiku 8 Të ardhurat vjetore të realizuara



Realizimi i të ardhurave nga pagesat rregullatore është 85.7 % të detyrimit vjetor të pagesave rregullatore, përcaktuar sipas kontratave që ERRU ka me operatorët.


Pavarësisht se ERRU, me të ardhurat e realizuara, ka mundur të mbulojë shpenzimet vjetore të vitit, arkëtimet nga pagesat rregullatore për vitin 2011, krahasuar me vitin 2010 kanë rënë në masën 24 %.

Gjatë këtij viti janë arkëtuar edhe detyrime të viteve të mëparshme konkretisht 42 % e vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nga vitet e mëparshme.

Shpenzimet operative

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, pavarësisht se ERRU është institucion i pavarur, jo buxhetor, plani vjetor i shpenzimeve operative miratohet me Vendim të KM. Për vitin 2011 ky plan është miratuar me VKM nr. 20, datë 12.01.2011, “Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2011, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”. Fondi vjetor i shpenzimeve operative të Entit për vitin 2011 është në shumën 34.245.000 leke dhe i detajuar në zëra si me poshtë:


Grafiku 9 Struktura e detajuar e planit të shpenzimeve



Gjatë këtij viti shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit janë në shumën 29 528 488 lekë, ose 86.22 % të fondit të planifikuar. Nga këto:

- 18,320,087 lekë, shpenzime për pagat e punonjësve.
- 1,619,365 lekë, shpenzime për sigurime shoqërore të punonjësve.
- 7,370,600 lekë, shpenzime të kryera për shërbime të furniturë.
- 2,218,440 lekë, shpenzime për investime.

Grafiku 10 Realizimi i planit të shpenzimeve



Përdorimi i fondeve të planifikuara, është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi si për trajtimin me paga e shpërblime të punësuarve ashtu dhe për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike”.

2. Gjendja në sektorin Ujësjellës Kanalizime

Performanca e shërbimit në sektorin UK

Sektori i shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura gjithmonë e më shumë nga pikëpamja institucionale po formatizohet sipas kuadrit ligjor. Nga 56 operatorë që sot operojnë në këtë sektor 48 janë licencuar dhe 44 prej tyre kanë tarifa të miratuara nga ERRU. Ofrimi i shërbimit nga operatorë të licencuar është i rëndësishëm pasi garanton konsumatorët së shërbimi u ofrohet nga operatorë të kualifikuar dhe se ata paguajnë tarifa të drejta.

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që ofrohet nga 56 operatorë nuk është i mundur në të gjithë territorin e vendit. Popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga këta operatorë jeton kryesisht në zonat urbane. Konkretisht, operatorët mbulojnë me shërbimin e furnizimit me ujë rreth 80% të popullsisë në zonën e juridiksionit dhe me shërbimin e largimit të ujërave të ndotura rreth 67% të saj.

Jo të gjithë operatorët që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë kryejnë edhe shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, vetëm 28 prej tyre kryejnë të dy shërbimet. Për pjesën tjetër të popullsisë shërbimi i furnizimit me ujë dhe grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura administrohet nga sektorë që veprojnë brenda njësive të qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive që nuk janë të licencuar nga ERRU sipas ligjit në fuqi.

Në përgjithësi çdo operator në Shqipëri e siguron furnizimin me ujë nga dy ose me shumë sisteme, të cilat mund të jenë me rrjedhje të lirë, me ngritje mekanike ose të kombinuar. Prodhimi nga sistemet me rrjedhje të lirë zë vetëm 9% të totalit të ujit të prodhuar dhe pjesa tjetër prodhohet nga sistemet me ngritje mekanike dhe të kombinuar.

Aktualisht, sasia e ujit të prodhuar mbulon kërkesën për ujë të të gjithë konsumatorëve. Shërbimi i kanalizimeve për shumicën e operatorëve nënkupton grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura dhe i ofrohet kryesisht klientëve në zonat urbane, ndërsa trajtimi i tyre kryhet vetëm nga dy operatorë.

Gjendja e sektorit UK në tërësi analizohet ERRU nëpërmjet disa treguesve kryesor të performancës të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2 Trendi i treguesve të performancës¹

Nr.	Treguesit e Performancës	2010	2011
1	Mbulimi i Kostos Totale	51 %	52 %
2	Mbulimi i Kostos O&M	71 %	71 %
3	Furnizimi me ujë (ore/dite)	11.1	11.43
4	Uji i Pafaturuar	63 %	63 %
5	Sasia e Ujit të matur	45 %	59 %
6	Niveli i Arkëtimeve	84 %	76 %
7	Efiçenca e stafit (Staf/1000 lidhje)	13.8	14.8
8	Zona e mbulimit me KUN	50 %	50 %

¹ Përlogaritja e treguesve të mësipërme për vitin 2011 është bere duke ju referuar te dhënatë të marra nga Njësia e Monitorimit DPUK për 9 mujin e pare te vitit 2011. Ne raportin vjetor 2010 treguesit e performancës te vitit 2010 jepen për 6 mujin e parë.

Cilësia e shërbimit ne sektor

ERRU ka vlerësuar performancën e operatoreve në lidhje me cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve mbi bazën e analizës dhe monitorimit të vazhdimësisë së shërbimit, ndërprerjeve të planifikuara dhe të paplanifikuara të ujit, dëmtimeve në rrjet, si dhe cilësisë së ujit të pijshëm.

Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve nuk është në nivel të mirë dhe reflektohet në mos furnizimin e vazhdueshëm të klientëve me ujë të pijshëm dhe me presionin e duhur. Duke iu referuar të dhënave të Njesisë së Monitorimit dhe Benchmark pranë DPUK, shkalla e furnizimit me ujë varion nga 4 - 24 orë ujë në ditë edhe gjatë vitit 2011. Në vitin 2010 konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 11.1 orë në ditë ndërsa në vitin 2011 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë është 11.4 orë në ditë.

Operatorët që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur janë të paktë në numër. Pjesa më e madhe e operatorëve ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për 61 % të operatorëve varion nga 8-20 orë në ditë, ndërsa për 39% të operatorëve kohëzgjatja e furnizimit me ujë është rreth 4-8 orë në ditë.

Gjithashtu, cilësia e shërbimit ulet edhe si rezultat i numrit të lartë të ndërprerjeve të paplanifikuara në furnizimin me ujë dhe dëmtimeve në rrjet. Përsa i përket cilësisë së ujit të pijshëm, operatorët edhe institucionet përgjegjëse bëjnë kujdes për kontrollin e tij. Instituti i Shëndetit Publik bën kontrollin dhe monitorimin e përditshëm të të dhënave të cilësisë së ujit për konsum publik, kryesisht në zonat urbane të vendit, por edhe vetë operatorët bëjnë kujdes për trajtimin e ujit të pijshëm. Në të gjitha sistemet e furnizimit me ujë behet dezinfektimi i ujit.

Përsa i përket ujërave të ndotura, ende nuk mund të flasim për cilësi përderisa ato nuk trajtohen përpara shkarkimit. Aktualisht funksionojnë vetëm dy impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, ai i Pogradecit dhe i Kavajës. Shkarkimi i ujërave të ndotura nga sistemet e kanalizimeve pa u trajtuar krijon probleme mjedisore në zonën e tyre të shkarkimit. Por situata do të vijë duke u përmirësuar pasi gjatë vitit 2011 ka përfunduar ndërtimi dhe së shpejti do të vihen në funksionim edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Korçë dhe Durrës, dhe janë në ndërtim edhe tre impiante të tjera.


Uji i pafaturuar

Uji i pafaturuar përfaqëson diferencën ndërmjet volumit të ujit të prodhuar dhe atij të faturuar. Në gjuhën ekonomike përfaqëson sasinë e ujit që nuk sjell të ardhura (humbjet), dhe është i lidhur me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Në vitin 2011 niveli mesatar i humbjeve rezulton të jetë në të njëjtin nivel me atë të vitit 2010. Mesatarisht niveli i humbjeve në sektor është 63% e ujit të prodhuar. Megjithëse shumë operatorë kanë arritur rezultate pozitive në uljen e nivelit të humbjeve, nga ana tjetër shumë operatorë të tjerë me gjithë punën e bërë në këtë drejtim, pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet.

Me përjashtim të humbjeve teknikisht të lejuara që vijnë si rezultat i mënyrës së funksionit të sistemit, humbjet e tjera vijnë si rezultat i amortizimit të rrjetit, i lidhjeve të paligjshme të paidentifikuara, i lidhjeve jashtë ujëmatësit apo i mungesës së vetë matësit. Niveli i lartë i humbjeve vazhdon të mbetet një prej problemeve të performancës së operatoreve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë. Ky tregues ka impakt negativ në qëndrueshmërinë financiare të operatoreve, jo vetëm për arsye se niveli i lartë i humbjeve i detyron operatorët të prodhojnë me shumë ujë dhe shpenzimet për prodhimin dhe shpërndarjen e ujit janë me të mëdha se sa është nevoja, por edhe për faktin se uji i pafaturuar nuk sjell të ardhura.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve. Së pari, operatorët duhet të kryejnë studime të mirëfillta për vlerësimin e kërkesës për ujë, evidentimin dhe vlerësimin e humbjeve sipas shkakut, gjë e cila do të ndihmonte ata në hartimin e strategjisë për uljen e tyre.

Grafiku 11 Humbjet ne %



Konsumi i matur

Çdo konsumator duhet të paguajë për atë që konsumon, por kjo ende nuk është e mundur pasi jo të gjithë paguajnë për atë që realisht konsumojnë, sepse kemi ende nivele të larta të faturimit aforfe.

Niveli mesatar i konsumit të matur në vitin 2011 është rritur 14% krahasuar me vitin e mëparshëm. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm ka luajtur zbatimi i akteve ligjore në fuqi për pajisjen me ujëmatës të konsumatorëve jo familjarë proces i monitoruar nga ERRU gjatë vitit 2011. Nga ana tjetër, zbatimi i kontratës model, që rregullon marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve dhe operatorit ka rritur ndërgjegjësimin e konsumatoreve për tu pajisur me ujëmatës.

Një faktor tjetër që ka ndikuar pozitivisht në këtë drejtim është edhe rritja e tarifave. Aktualisht konsumatorët paguajnë tarifa më të larta krahasuar me vitet e mëparshme. Praktika ka treguar se konsumi ulet nëse ai matet. Konsumatorët stimulohen të kufizojnë konsumin e ujit të pijshëm dhe mos shpërdorimin e tij. Kërkesa për të paguar në bazë të sasisë së konsumuar ka rritur kërkesën e konsumatorëve për tu pajisur me ujëmatës.

Nga ana tjetër, ulja e konsumit redukton kërkesën për ujë dhe ndihmon në mirë planifikimin e të gjithë elementeve të sistemit.

Tabela 3 Tendenca e faturimit të matur në vite


Vitet	Totali i Faturimit m ³	Faturimi i matur m ³	Faturimi i matur %	Trendi
2008	86,089	34,265	40	↗
2009	90,640	37,607	41	↗
2010	122,501	54,967	45	↗
2011	108,400	64,273	59	↗

Norma e arkëtimit

Burimi kryesor i të ardhurave të operatorëve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura mbeten të ardhurat që realizohen nga shërbimet që ata ofrojnë për konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit. Arkëtimi i të ardhurave si burimi kryesor i likuiditeteve duhet të jetë në qendër të veprimtarisë së operatorëve. Duke iu referuar të dhënave të DPUK për vitin 2011, rezulton se niveli mesatar i normës së arkëtimit për sektorin është ulur krahasuar me vitin 2010.

ERRU konstaton se përgjithësisht operatorët gjatë këtij viti nuk kanë treguar të njëjtën vëmendje në drejtim të arkëtimit të të ardhurave si në vitin e kaluar, prandaj edhe niveli i këtij treguesi pothuajse për të gjithë operatorët është ulur.


Grafiku 12 Numri i shoqërive sipas normës së arkëtimit




Mbulimi i Kostos Operative dhe Kostos Totale

Objektivi kryesor i çdo operatori është mbulimi i kostos totale me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor si dhe të ardhurat e tjera që realizojnë nga shërbimet që kryejnë. Vetëm katër operatorë e kanë arritur këtë objektiv. Përgjithësisht operatorët që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura synojnë mbulimin e kostos operative me të ardhurat nga aktiviteti. Por ka ende operatorë, kryesisht operatorë të vegjël, që me të ardhurat e tyre nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë.

Grafiku 13 Mbulimi i Kostos O&M me të Ardhura / Arkëtime




Grafiku 14 Mbulimi i Kostos Totale me të Ardhura / Arkëtime

Duke iu referuar tabelës së mësipërme rezulton se në vitin 2011 niveli mesatar i mbulimit të kostos operative me të ardhurat për sektorin është 71.1% dhe mbulimi i kostos totale me të ardhurat është 52.3%. Krahasuar me një vit më parë tendenca për mbulimin e kostos operative apo edhe të kostos totale me të ardhurat nga aktiviteti është pozitive.

Situata nuk është aspak e kënaqshme nëse do t'i referohemi treguesit të mbulimit të kostos operative dhe totale me arkëtimet. Niveli mesatar i mbulimit të kostove operative dhe totale me arkëtimet për vitin 2011 jo vetëm është i ulët por edhe tendenca e këtij treguesi ka qënë negative. Megjithatë në vitin 2011 gati 50% e operatorëve kanë rritur ndjeshëm të ardhurat si rezultat i rritjes së tarifave, niveli i mbulimit të kostove nuk është përmirësuar pasi edhe shpenzimet janë rritur me po të njëjtin ritëm.

Përmirësimi nuk mund të vijë vetëm si rezultat i ndryshimit të tarifave por edhe i zbatimit të praktikave bashkëkohore në menaxhimin e shërbimeve që do të sillte përmirësimin e performancës së tyre. Mbatja nën kontroll e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve do të përmirësonte këtë tregues. Në totalin e kostos për shërbimet UK, kosto e shërbimit të furnizimit me ujë zë 75-80% të shpenzimeve që kryejnë operatorët.

Grafiku 15 Struktura e shpenzimeve

Tre janë zërat e kostos që zënë peshën specifike më të madhe në totalin e kostos, kostot e personelit, të energjisë elektrike dhe amortizimit.

Kostot për personelin vazhdojnë të jenë të larta. Përgjithësisht operatorët UK kanë numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje që tregojnë për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 14.8 punonjës/1000 lidhje. Për një numër të vogël operatorësh niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje është 4-5 punonjës.

Operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, kostoja e energjisë elektrike zë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në nivelin e këtyre shpenzimeve për furnizimin me ujë janë niveli i humbjeve dhe amortizimi i sistemit të pompave. Niveli i lartë i humbjeve bën që operatorët të prodhojnë me shumë ujë se kërkesa, gjë e cila rrit konsumin e energjisë elektrike. Deri tani asnjë operator nuk ka paraqitur një studim në lidhje me përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Shpenzimet për energjinë elektrike janë rritur edhe për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos për ata operatorë që administrojnë edhe impiantet e trajtimit.


Një element i rëndësishëm në totalin e kostos është amortizimi i aseteve vlera e të cilit po vjen duke u rritur, sidomos për ata operatorë të cilët kanë kryer apo po kryejnë investime për rehabilitimin, zgjerimin e sistemit të ujësjellës kanalizime dhe për operatorët që tashmë kanë në përdorim impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Megjithatë kosto e materialeve dhe mirëmbajtjes nuk zë një vend të rëndësishëm në strukturën e kostos, në vitin 2011 u vu re se tendenca e tyre është në rritje, si rezultat i rikonstruksioneve të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe ndërtimi i impianteve për përpunimin e ujërave të ndotura.

Edhe për vitin 2011, burimi kryesor i të ardhurave për operatorët kanë qënë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët. Gjatë këtij viti sektori ka gjeneruar rreth 14% më shumë të ardhura krahasuar me një vit më parë. Rreth 80% e kësaj rritje ka ardhur nga rritja e tarifave dhe 20% si rezultat i rritjes së nivelit të faturimit.

Një burim tjetër i të ardhurave për operatorët është edhe subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit, i cili sidomos për operatorët e vegjël zë një vend të rëndësishëm në totalin e të ardhurave. Subvencioni është përdorur kryesisht për pagesën e shpenzimeve të energjisë elektrike, shlyerjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore, blerje kimikate apo riparime të vogla.

Grafiku 16 Struktura e të ardhurave



Burimi: DPUK, MPPTT

Në sektorin ujësjellës kanalizime janë kryer dhe po vazhdojnë të kryhen investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve apo ndërtimin e sistemeve të reja. Një vend të rëndësishëm zënë investimet për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Burimi kryesor i investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit, si dhe kreditë dhe grantet nga donatorët e huaj. Por gjatë vitit 2011 disa operatore kanë përdorur edhe burimet e tyre financiare për të kryer investime kryesisht për rikonstruksione apo zgjerimin zonës së tyre të shërbimit.

3. Këndvështrimi për vitin 2012

Viti 2012 do të jetë një vit tjetër progresi për ERRU në drejtim të një performance gjithnjë në rritje në ushtrimin e të funksionit të tij dhe në zbatimin e mandatit dhe misionit rregullator. ERRU do të vazhdojë të ndër marrë iniciativa, që do të fokusohen në arritjen e objektivave të tij. Për vitin e ardhshëm janë parashikuar aktivitetet e mëposhtme:

- Të vazhdojë procesi i liçencimit të të gjithë ofruesve të shërbimit që operojnë në sektorin UK;
- Të zbatojë Metodologjinë e re të Vendosijes së Tarifave në mënyrë objektive dhe transparente.;
- Të vijojë të mbetet i pari çështjen e mbrojtjes së konsumatorëve me aktivitetet e mëposhtme:
 - Me përgatitjen e një Manuali për Shërbimin me Klientin i cili to të jetë i detyrueshëm për të gjithë operatorët UK;
 - Me rishikimin e menaxhimit të ankesave nga ana e ERRU;
 - Aktivitete të mëtejshme për rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve UK lidhur me çështjet e konsumatorëve;
- Të vijojë zbatimin e Planit të Veprimit për aplikimin në rang kombëtar të Kontratës së Konsumatorit;
- Të përgatisë një Manual Rregullator për Planet e Biznesit, që specifikon elementët e kërkuar nga ERRU për analizën e aplikimeve për tarifa disavjeçare;
- Të zhvillojë në partneritet standarte minimale të shërbimit në sektorin UK;
- Të zhvillojë në partneritet standarte për efikasitetin e energjisë në sektorin UK;
- Të mbështesë procesin e zbatimit të Strategjisë së Sektorit UK në përgjithësi dhe veçanërisht në fushat ku ERRU është identifikuar si institucion udhëheqës;
- Të finalizojë studimin “Perceptimi i Konsumatorëve për Cilësinë e Shërbimit” me operatorët pilot të përzgjedhur dhe të zhvillojë në partneritet këtë projekt me të gjithë operatorët e tjerë të Sektorit të UK;
- Të përmirësojë manualin përkatës dhe të vazhdojë në partneritet zbatimin e masave për trajnimin e Anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës për të gjithë operatorët UK;
- Të zhvillojë rregullore përkatëse për të ushtruar proceset rregullatore veçanërisht në zona rurale, që nuk janë përfshirë akoma në këtë rregullim;
- Të vazhdojë të konsolidojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët në sektorin UK;

- Rishikimi i legjislacionit me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të rolit dhe funksionit të ERRU dhe të arrijë harmonizimin e legjislacionit, me direktivat e BE-së.

4. Rekomandime për sektorin UK

- Rishikimi i çështjes së ofrimit të shërbimit nga operatorët UK, të cilët nuk arrijnë të përmbushin kushtet e marrjes së licencës së shërbimit, në mënyrë që aty ku është e mundur, këto shërbime të integrohen pranë operatorit të licencuar që është përgjegjës për ofrimin e këtij shërbimi në zonën përkatëse të juridiksionit.
- Përmirësimi i performancës së sektorit për Treguesit Kryesorë Performancës² ERRU në përputhje me legjislacionin në fuqi do të ushtrojë rolin e tij si monitorues të këtyre treguesve.
- Qeverisja vendore duhet vazhdojë të rrisë rolin e saj në drejtim të ushtrimit të autoritetit të saj si pronar, këtë në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit të operatorëve UK. Kjo mund të kërkojë mbështetje të mëtejshme në ngritjen e kapaciteteve dhe në marrjen masave ndërgjegjëse.
- Këshillat Mbikëqyrës duhet të vazhdojnë rritjen e rolit dhe përgjegjësisë së tyre si autoritetet qeverisëse i operatorëve UK, siç parashikohet në legjislacionin përkatës.
- Operatorët UK duhet vënë përmirësimin e kostove të shërbimit në lidhje me treguesin e efikasitetit të energjisë në fokus të punës së tyre.
- Operatorët UK duhet të punojnë për përmirësimin e punës së tyre me fokus në marrëdhënien me konsumatorët.
- Të gjithë operatorët UK duhet të vazhdojnë implementimin e kontratës model midis operatorit dhe klientit, proces i cili duhet të jetë transparent dhe i monitoruar nga ERRU;
- Operatorët UK duhet të përfundojnë instalimin e ujëmatësve për klientët jo-familjarë, gjithashtu të vazhdojnë me ritme të shpejta instalimit i ujëmatësve për konsumatorët familjarë.
- Finalizimi i Masterplanit për investime në sektorin UK në Shqipëri duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur. Shpërndarja e investimeve duhet të jetë e lidhur ngushtë edhe me përmirësimin e indikatorëve të performancës.
- Rishikimi i skemës së subvencioneve, që është iniciuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, duhet të vazhdojë dhe të finalizohet në bashkëpunim të ngushtë me ERRU, Ministrinë e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore. dhe përfshirjen në planin e shpërndarjes së tyre.
- Sistemi kombëtar i monitorimit të cilësisë së ujit duhet të zhvillohet më tej duke përfshirë aktivitete më intensive inspektimi në rang lokal, verifikimin e të dhënave të raportuara dhe pajisjen e operatorëve të mëdhenj me laboratorët përkatës.
- Së fundmi, sukcesi i reformimit dhe zhvillimit të sektorit shqiptar UK do të varet edhe nga bashkëpunimi i hapur ndërmjet institucioneve të përfshira.

² Këto janë mbulimi i kostos (O&M, kostot totale), mbulimi me shërbim (ujësjellës dhe kanalizime), humbjet, efikasiteti i faturimit, norma e arkëtimit, niveli i matjes, dhe orët e shërbimit.

Enti Rregullator i Ujit

Blv. Gjergj Fishta, Godina Nr.10, Kati IV

Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 2 258 046

<http://www.ERRU.al>